



Vllaznia nuk ia ka dalë të marrë pikë as në ndeshjen e javës së 14-të, atë të luajtur pasditen e së shtunës në Vlorë ndaj Flamurtarit. Kanë qenë vendasit ata të cilët kanë fituar me rezultatin 2-0. Takimi ka nisur me gol për ta. Që në minutën e 8-të, Musta ka kaluar në avantazh vlonjatët dhe padyshim që ky gol do të ndikonte në ecurinë e mëtejshme të lojës. Marku është dëmtuar pas një përplasje me kundërshtarit dhe ka qëndruar me shumë vështirësi në fushë. Atsina po ashtu ka ndjerë shqetësime në gju dhe është zvendësuar në minutën e 10-të. Padyshim që këto probleme do të ndikonin në ecurinë e mëtejshme të lojës së Vllaznisë. Megjithatë ajo u përpoq që të shënonte golin e barazimit dhe sidomos në pjesën e dytë ka luajtur më mirë se kundërshtari. Në minutën e 74-të futbollistët tanë protestojnë për një prekje të topit me dorë nga Bicaç brenda zonës por arbitri nuk akordon 11-metërsh. Në minutën e 88-të ndërkohë, një gabim në mbrojtje bën që Flamurtari të shënojë edhe golin e dytë. Në minutat shtesë, Orelesi shënon një gol mëse të rregullt por për çudi ai anulohet në mënyrë të çuditshme. Përfundimisht 2-0 për Flamurtarin.

© **vllaznia.al**